



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 13/61
Datë: 22.08.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 gusht 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Zhvillim Rajonal në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Koncept Dokument

Zhvillimi Rajonal në Kosovë

Korrik, 2018

PËRMBAJTJA:

PËRKUFIZIMET	3
KAPITULLI I: HYRJE.....	5
KAPITULLI II: PËRSHKRIMI DHE DEFINIMI I ÇËSHTJES.....	6
PROGRAMI AKTUAL	8
SHPENZIMET AKTUALE	9
PËRVOJAT NGA SHTETET TJERA DHE BE-JA	9
NOMENKLATURA E NJËSIVE TERRITORIALE STATISTIKORE (NUTS-RAJONET)	11
SHTETET E RAJONIT	12
KAPITULLI III: SYNIMI DHE OBJEKTIVAT.....	14
SYNIMI	14
OBJEKTIVAT.....	14
KAPITULLI IV: OPSIONET	15
OPSIONI 1 – STATUS QUO	15
”OPSIONI 2 - ZHVILLIMI I BALANCUAR RAJONAL	15
OPSIONI 3 -	16
KAPITULLI V: PËRMBLEDHJE E OPSIONEVE.....	17
KAPITULLI VI: ANALIZA E OPSIONEVE.....	19
PËRFITIMET.....	19
PASOJAT NEGATIVE	19
EFEKTI SHPËRNDARËS.....	19
KOSTO	20
KAPITULLI VII: KONSULTIMET	21
KAPITULLI VIII: KRAHASIMI I OPSIONEVE	22
KAPITULLI IX: REKOMANDIMI	22
KAPITULLI X: KOMUNIKIMI.....	22
SHTOJCA: 1.....	23
SHPENZIMET OPERATIVE DHE KAPITALE TE SHENDETËSISË SIPAS KOMUNAVE PËR VITIN 2016	23
SHTOJCA: 2.....	25
SHPENZIMET OPERATIVE DHE KAPITALE TE ARSIMIT SIPAS KOMUNAVE PER VITIN 2016.....	25
SHTOJCA: 3.....	27
POPULLSIA, VENDBANIMET DHE SIPERFAQJA E KOMUNAVE TE REPUBLIKËS SË KOSOVËS	27
SHTOJCA: 5.....	29
NDËRMARRJET E REGJISTRUARA NE KOSOVË SIPAS LLOJIT TE PRONËSISË DHE NUMRIT TË PUNËTORËVE.....	29
SHTOJCA: 6.....	30
SHKOLLAT SIPAS NIVELIT ARSIMOR NË ARSIMIN FILLOR, ARSIMIN E MESËM TË ULËT DHE TE MESEM TE LARTË – ARSIMI PUBLIK 2015-2016.....	30
SHTOJCA: 7 KOORDINIMI I KOMUNAVE NGA MINISTRITË E LINJES.....	31
SHTOJCA: 8 KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2017 – 2019	36

PËRKUFIZIMET

»**Rajon zhvillimor**« është territor funksional për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, të inkorporuara, me vendbanime, ekonomike, infrastrukturore dhe sisteme natyrore në një bashkësi hapësinore uniforme të balancuar ku mundësit e barabarta për zhvillim të balancuar rajonal mund të jepen;

»**Zhvillimi rajonal**« është një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajone;

»**Rajon kohezivë**« është territor funksional për zbatimin e detyrave të përbashkëta të komunave dhe shtetit, e posaçërisht në drejtim të zbatimit të politikave kohezive;

»**Pabarazi rajonale**« është gjendje kur në mes rajoneve të caktuara kemi dallime substanciale në disa indikatorë socio-ekonomik (GDP/Capita; investime për kokë banori; niveli i papunësisë etj.) por Jo vetëm;

»**Zhvillimi i balancuar rajonal**« procesi i uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik dhe cilësisë së jetës në rajone të ndryshme;

»**Politikat për zhvillim rajonal**« japin kornizën e zhvillimit rajonal dhe intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të drejtohen për arritjen e synimit të zhvillimit të balancuar rajonal;

»**Programe për zhvillim rajonal**« është program bazë i cili përmban avantazhet zhvillimore të rajonit zhvillimor, duke definuar prioritetet zhvillimore të rajoneve dhe që përmban programe të vlerësuara financiare për zhvillim dhe promovim të rajonit zhvillimor;

»**Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021**« është një dokument që paraqet bazën e punës së qeverisë dhe fokusin në 4 shtyllat kryesore për një sistem të integruar të planifikimit: Sundimi i Ligjit; Zhvillimi ekonomik dhe Punësimi; Integrimet Euro-Atlantike dhe Zhvillimi Sektorial.

»**Strategjia Kombëtare për Zhvillim**« është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës dhe përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror;

»**Programi Kombëtar për Reforma Ekonomike**« është një dokument i cili paraqet përpjekjet për forcimin e rritjes ekonomike përmes përsheptimit të reformave ekonomike dhe përmirësimit të mëtejshëm të mjedisit të biznesit që të jetë më i favorshëm për rritjen e sektorit privat;

»**Korniza afatmesme e shpenzimeve**« paraqet dokument kryesor mbi bazën e të cilit hartohet buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofroj një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë;

»**Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026**« është një dokument i cili paraqet orientimet strategjike për thellim të reformave dhe sistem të unifikuar të vetëqeverisjes lokale në Kosovë si dhe një udhëzues i qartë i politikave qeveritare lokale.

Kapitulli I: Hyrje

Koncepti dokumenti për Zhvillim Rajonal pasqyron sfidat, problemet dhe ngecjet në fushën e zhvillimit rajonal që duhet adresuar me qëllim të përafrimit me politikën e zhvillimit rajonal të BE-së¹. Përgatitja e konceptit dokumentit është paraparë në planin e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018² (Tabela B, MZHR, Objektivi 1, Aktiviteti 1.1.), dhe është pjesë e Listës së koncepteve dokumenteve për vitin 2018³. Koncepti dokumenti është njëkohësisht pjesë e Strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026⁴ (fq.73-74 shtojca 2).

Koncepti dokumenti për zhvillim Rajonal ndërlidhet me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021⁵, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH)⁶, Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike (PKRE) 2015⁷, dhe Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2018-2020⁸.

Dokumenti është prioritet për arsye të definimit të politikave të zhvillimit rajonal në Kosovë. Gjithashtu koncepti dokumenti mbështetet edhe në rekomandimet e BE-së të dala nga takimi i Dialogut të Procesit për Stabilizim Asociativ (DPSA)/Komiteti Sektorial për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal, si në vijim:

1. Zhvillimi rajonal në Kosovë të përqendrohet në kuptim të përfitimit të fondeve të BE-së „rajone kohezive” NUTS II, ose
2. Zhvillimi rajonal me qëllim të zhvillimit të rajoneve specifike NUTS III. (kur kjo të jetë e aplikueshme në Kosovë)

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociativ (MSA) ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka hapur rrugën drejtë planifikimit të zhvillimit të mirëfilltë lokal si dhe atij rajonal. Ndër të tjera, MSA parasheh se “palët do të përpiqen të identifikojnë masat për të forcuar bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e pabarazive rajonale.” Kujdes i veçantë do t’i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, trans-kombëtar dhe ndër-rajonal. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat me prioritet në kontekstin e Acquis të BE-së. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë për qasje në programet e BE-së mes qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian më datën 25.11.2016, ofron një mundësi shtesë për mobilizimin e fondeve për efekt të zhvillimit rajonal.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim në seksionin për industrinë konkurruese, saktësisht “Kalimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar” në masat që i planifikon, njeh rajonet ekonomike si realitet i cili ekziston dhe AZHR-të si aktorë të cilët mund të jenë relevantë në implementimin e masave të planifikuara në këtë dokument (dokumenti SKZH 2016-2021, fq 33, aktiviteti 5).

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pushteti është i ndarë në dy nivele:

¹ http://ec.europa.eu/regional_policy/en/policy/how/priorities

² Plani i punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2018

³ Lista e koncepteve dokumenteve për vitin 2018

⁴ Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq.73, paragrafi 2

⁵ Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021

⁶ Strategjia Kombëtare për zhvillim

⁷ Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike (PKRE) 2015

⁸ Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2018-2020

1. Pushtetit qendror;
2. Pushteti lokal (Komunat), me kompetenca të definuara dhe të ndara nga pushteti qendror sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Andaj, ky dokument në përdorimin e përkufizimit të Zhvillimit Rajonal në asnjë aspekt nuk prejudikon dhe as për bazë nuk merr ndonjë mënyrë të ndarjes administrative në nivel rajoni. Gjithsesi sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës (Ligji për bashkëpunim ndërkomunal)⁹ është i mundshëm bashkëpunimi ndërkomunal ku komunat mund të ndërtojnë partneritete për nevojat e zhvillimit ekonomik ose adresimit të problemeve me interes të përbashkët në kuadër të kompetencave vetanake të cilat i kanë dhe me pëlqim të MAPL-së.

Kapitulli II: Përshkrimi dhe definimi i çështjes

Zanafilla e Zhvillimit Rajonal në Kosovë njihet që më herët, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008. Me iniciativë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe mbështetjes të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) janë nënshkruar pesë marrëveshje ndërkomunale të partneritetit për krijimin e pesë Agjencive për Zhvillimin Rajonal (AZHR). Këto marrëveshje janë nënshkruar me 16 dhjetor të vitit 2008.

Në vazhdimësi të kësaj, Qeveria e Kosovës në vitin 2009 ka filluar procesin e planifikimit të Programeve për Bashkëpunim Ndërkufitar të financuara nga BE-ja me shtetet fqinje (Kosovë–Shqipëri; Kosovë–Maqedoni) dhe një vit më vonë Kosovë–Mali i Zi. Në të gjitha këto programe, rajonet e propozuara për përfshirje si zona të pranueshme në program kanë ndjekur klasifikimin Evropian të rajoneve NUTS III (edhe pse Kosova nuk ka të aplikuar të njëjtin klasifikim). Si bazë për këtë janë marrë Rajonet ekonomike të cilat AZHR-të i përfaqësojnë:

1. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Qendër¹⁰ - Rajoni Ekonomik Qendër
2. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Lindje – Rajoni Ekonomik Lindje
3. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Perëndim – Rajoni Ekonomik Perëndim
4. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Jug – Rajoni Ekonomik Jug
5. Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndër-komunal Veri – Rajoni Ekonomik Veri

Figura 1: Rajonet ekonomike në Kosovë – AZHR

⁹ Ligji për bashkëpunim ndërkomunal

¹⁰ Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndër-komunal (për themelimin e AZHR-ve: Qendër, Lindje, Perëndim, Jug dhe Veri), 16.12.2008. AZHR – ne baze te kesaj kane zhvilluar Strategji te Rajonale per Zhvillim, per periudhen 2010-2013. AZHR-të kanë përditësuar të dhënat statistikore socio-ekonomike gjatë vitit 2014. Të njëjtat strategji mund të konsolidohen dhe të shërbejnë për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Rajonal.



Definimi i problemit: Kosova aktualisht ka mungesë të infrastrukturës ligjore dhe strategji për zhvillim rajonal. Mungesa e përcaktimit të politikave të qarta për zhvillim rajonal sjellin probleme të shumta si në vijim:

1. Pabarazi rajonale nga aspekti të indikatorëve socio-ekonomik;
2. Mungesë të politikave zhvillimore për të nxitë konkurrencë më të madhe në rajon;
3. Mos ndërlidhja në mes të politikave sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në nivele të rajoneve si;
4. Mungesë të stimulimit të bashkëpunimit ndër-rajonal, ndërkufitar dhe ndërkombëtarë;
5. Mos klasifikimi i Kosovës sipas rajoneve statistikore NUTS;
6. Mungesë të mekanizmave të nevojshme për qasje në fondet zhvillimore të BE-së dhe në për menaxhim të zhvillimit rajonal në përgjithësi;

Politika aktuale

Në Kosovë ekzistojnë politikat zhvillimore në nivel kombëtar, derisa ka mungesë të politikave për Zhvillim rajonal. Megjithatë, sipas Strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016 – 2026, parashihet hartimi i Politikave për Zhvillim Rajonal. Deri më tani ligji dhe rregullorja për bashkëpunim ndërkomunal është zbatuar si bazë për bashkërendimin e aktiviteteve për zhvillim rajonal.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet dhe aktet nënligjore në të cilat ky dokument është i bazuar janë si në vijim:

1. **Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale** - përcakton fuqinë e plotë të autoriteteve lokale për sa i përket interesave lokale. Ky ligji po ashtu përcakton kompetenca të qarta sa i përket organizimit dhe funksionimit të organeve komunale, financimit të komunave, marrëdhënieve brenda komunave, bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar si dhe marrëdhënieve ndërmjet komunave dhe nivelit qendror. Ligji për vetëqeverisje lokale liston fushat në të cilat autoritetet lokale kanë kompetenca ekskluzive dhe këto ushtrohen në përputhje me standardet e përcaktuara në ligjin në fuqi. Sipas këtij ligji, komunat kanë të drejt të bashkëpunojnë dhe krijojnë partneritete me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda fushës së kompetencave të tyre për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët. Po ashtu, komunat kanë të drejt të lidhin edhe marrëveshje bashkëpunimi me organ të huaja të vetëqeverisjes lokale.
2. **Ligji Nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal** – rregullon bashkëpunimin ndër-komunal midis komunave të Republikës së Kosovës për nevojat e ushtrimit të kompetencave të tyre vetanake

dhe të zgjeruara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin në fuqi si dhe Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale të Këshillit të Evropës. Po ashtu rregullohet edhe bashkëpunimi i komunave të Republikës së Kosovës me komuna ose institucione të tjera të qeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës në kuadër të binjakëzimit ose formave të tjera të bashkëpunimit brenda kompetencave vetanake dhe të zgjeruara të komunave. Ky ligj parasheh edhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal, ku dy ose me shume komuna kanë të drejtë të lidhin marrëveshje për qëllimet e tyre të përbashkëta në fushën e shërbimeve publike komunale si dhe atë të zhvillimit lokal.

3. **Rregullorja për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal** – rregullon nxitjen dhe përkrahjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Në veçanti, përcakton fushat/kompetencat si dhe kriteret për bashkëpunim përfshirë: Zhvillimin socio-ekonomik lokal dhe rajonal, zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës, planifikimi urban dhe rural, mbrojtja e mjedisit, promovimi dhe zhvillimi i turizmit, promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, zhvillimi i infrastrukturës ndër-komunale, si dhe çështje tjera që janë në kompetencë vetanake të komunave.
4. **Rregullorja për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar** – përcakton formën dhe procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtarë në mes të institucioneve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës me komunat dhe institucionet tjera të vetëqeverisjes lokale jashtë Republikës së Kosovës. Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje bashkëpunimi të karakterit administrativ dhe teknik edhe me institucione tjera të qeverisjes lokale jashtë vendit. Bashkëpunimi ndërkombëtarë mundë të lidhet në disa fusha si në zhvillim ekonomik, planifikim urban dhe rural, zhvillim dhe shfrytëzimin e tokës, mbrojtjen e mjedisit lokal, ndërtimin dhe kontrollin sipas standardëve, ofrimin e arsimit publik, parashkollor, fillor dhe të mesëm, shëndetësinë publike, banimin publik, zhvillimin e infrastrukturës, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe shume çështje tjera që janë në kompetencë të komunave me legjislacion të zbatueshëm në Kosovë.
5. **RREGULLORE (QRK) NR.16/2017 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 02/2011 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE E NDRYSHUAR DHE E PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 07/2011, RREGULLOREN NR.14/2017 DHE RREGULLOREN NR.15/2017**- Kjo Rregullorë përcakton mandatin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Legjislacioni aktual nuk rregullon çështjet specifike për Zhvillim Rajonal si: zhvillimin rajonal të balancuar; zhvillimin socio-ekonomik rajonal, si dhe nuk ka të paraparë elemente që rregullon kornizën ligjore dhe të politikave për zhvillim rajonal.

Programi aktual

Në Kosovë aktualisht është themeluar Ministria e Zhvillimit Rajonal e cila më herët nuk ka ekzistuar dhe për këtë arsye më herët nuk ka patur ndonjë program për Zhvillim rajonal sepse nuk është trajtuar asnjëherë në nivel politikash si dhe strategjive adekuate. Por megjithatë në institucionet qeveritare, përkatësisht në MAPL ka ekzistuar Fondi për Zhvillimi rajonal (që nga viti 2012 deri në v.2017) i cili është menaxhuar nga Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal. Ky fond ka operuar në bazë vjetore me një buxhet prej 900.000 Euro dhe në të njëjtën kohë ka luajtur rolin e bashkëfinancimit të Programit të BE për Zhvillim Ekonomik Rajonal (EURED). Tashmë me themelimin e MZHR-së ka programe të parapara të cilat janë të dedikuara për zhvillim rajonal.

Shpenzimet aktuale

Shpenzimet të cilat mund ti atribuohen Zhvillimit Rajonal

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak 2017	Buxheti këtë vit 2018	KASH për vitin e ardhshëm 2019
Buxheti i MZHR-së			
- - Pagat e e mëditje	25,000.00	307,000.00	307,000.00
Mallra e sherbime	10,000.00	340,000.00	340,000.00
- Subvencione e Transfere	0.00	1,500,000.00	1,500,000.00
- Investime kapitale		2,000,000.00	2,000,000.00
<i>Buxheti i MAPL-së</i>			
- Investime kapitale	900,000.00		
- Pagat e DBZHR/Div.ZHR	37,000.00		
<i>Buxhetet tjera:</i>			
- buxhetet komunale (participimi në shpenzime operative te AZHR-ve)	140,000.00	140,000.00	140,000.00
<i>Financimi nga donatorët</i>			
- ZBEK			
- Granti i veprimit të AZHR-ve	471,532.94	255,000.00 *	
Totali			

Burimi i informatave të përdorura në tabelë: KASH 2017-2019 dhe KASH 2018-20 dhe Zyra e Bashkimit Evropian ne Kosovë

Në tabelën e mëhershme nuk janë paraqitur shpenzime tjera në nivel të Ministrive të linjës të cilat koordinojnë aktivitetet në nivel rajonal. Në këtë tabelë nuk janë të përfshira edhe shpenzimet për bashkë-financimin e projekteve të Skemës së granteve te BE-së për Zhvillim rajonal dhe të implementuara nga vetë komunat. Shpenzimet operative të stafit të përfshirë në nivel lokal nuk janë të përfshira gjithashtu.

Përvojat nga shtetet tjera dhe BE-ja

Qasja e BE-së ndaj zhvillimit rajonal

Politika e Kohezionit synon të reduktoj pabarazitë mes rajoneve për të arritur zhvillim të balancuar ekonomik, social dhe territorial. Politika e Kohezionit origjinën e saj e ka në Traktatit i e Romes (1957) i cili shpreh domosdoshmërinë për të forcuar unitetin e ekonomive ne mes vendeve të BE-së dhe gjithashtu thekson nevojën për të siguruar zhvillimin e harmonizuar të rajoneve të pabarabarta duke zvogëluar dallimet që ekzistojnë midis rajoneve të ndryshme apo rajoneve më pak të zhvilluara ne aspektin socio-ekonomik. Gjithashtu, edhe Traktati i Lisbonës (2009), parasheh se për të nxitur zhvillimin ekonomik, Bashkimi Evropian duhet të hartojë dhe ndërmer veprime për të përforcuar kohezionin e tij ekonomik, social dhe territorial. Në mënyrë të veçantë, BE-ja, do të synojë reduktimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme. Në këtë drejtim, Bashkimi Evropian që prej vitit 2007 ka mbështetur zhvillimin ekonomik rajonal në Kosovë. Reformat në periudhën 2014-2020 janë bazuar në atë formë për të maksimizuar ndikimin e fondeve kohezive në dispozicion të BE-së.

Buxheti i përgjithshëm i BE-së, në periudhën 2014-2020 është 960 miliardë euro¹¹. BE-ja ka ndarë për bujqësi rreth 373.2 miliardë euro, kurse për politikën e kohezionit 352.5 miliardë euro. Gjithashtu, bazuar në strategjinë për politikën e kohezionit Evropa 2020, rritja nga këto fonde parashihet të bëhet sipas këtyre tri opsioneve: rritje ekonomike kreative, të qëndrueshme, dhe gjithëpërfshirëse.

Fondet në vijim janë pjesë e kornizës së tanishme legjislativë të politikës së kohezionit të BE-së:

1. Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF);
2. Fondi Evropian për Sektorin Detar dhe Peshkimin;
3. Fondet e Kohezionit (CF);
4. Fondi Social Evropian (ESF);
5. Fondi Evropian për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (EFARD).

Gjithashtu, duhet theksuar se edhe nëse qeveritë kombëtare mbeten përgjegjëse për vendime finale për ndarjen dhe monitorimin e fondeve strukturore, ata vazhdojnë të punojnë në menaxhim të përbashkët me Komisionin dhe partneritet me akterë të ndryshëm si organizatat jo-qeveritare dhe ato të biznesit. Parimi i partneritetit ju ofron akterëve rajonal legjitimitetin dhe mundësinë për t'u përfshirë në politikën e BE-së.

Traktati i Mastrohtit – i miratuar në vitin 1992, i cili ka hyrë në fuqi më 1 nëntor 1993 - ka njohur rëndësinë e rajoneve. Përveç parimit të subsidiaritetit Traktati në fjalë, është themeluar Komitetin e Rajoneve si një organ konsultativ i përbërë nga përfaqësues të rajoneve dhe ky komitet ka rol këshillues.

Korniza e tanishme legjislativë e politikës së kohezionit të BE-së ka krijuar 11 prioritete tematike si në vijim:

1. Kërkimi dhe Inovacioni;
2. Informacioni dhe teknologjitë e komunikimit;
3. Konkurrueshmëria e NVM; dhe
4. Ekonomi me emetim të ulët të karbonit.
5. Ndryshimet klimatike dhe mbrojtja nga rreziqet
6. Mjedisi dhe efica e resurseve;
7. Transporti dhe rrjetet energjetike;
8. Punësimi dhe tregu i punës;
9. Përfshirja sociale;
10. Arsimi dhe trajnimi; dhe
11. Administrata publike

Disa shembuj të parakushteve për fondet e BE-së, dhe dokumente, të cilat duhet të jenë të përgatitura nga shtetet aplikuese për të absorbuar fonde kohezive të BE-së dhe dokumentet të cilat shtetet duhet t'i përgatisin janë si në vijim:

1. Strategjia nacionale për transport;
2. Hartimi i ligjeve adekuate për mbrojtjen e ambientit;
3. Sistemi i avancuar i prokurimit publik;
4. Reforma të përshtatshme dhe miqësore për bizneset;
5. Strategji të specializuara dhe kreative për investime;

¹¹http://www.europa.eu/regional_policy/sources/docoffic/official/regulation/pdf/2014

Nomenklatura e njësive territoriale statistikore (NUTS-rajonet)

Klasifikimi bëhet sipas nivelit NUTS (Nomenclature of territorial Units for Statistics - *Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika*) i cili është një sistem hierarkik për të drejtuar dhe orientuar territorin në aspektin ekonomik të BE-së për qëllime të:

1. Mbledhjes, zhvillimi dhe harmonizimi i regjioneve statistikore të Evropës;
2. Analizës socio-ekonomike e regjionit:
 - 2.1. NUTS 1: regjionet e mëdha socio-ekonomike
 - 2.2. NUTS 2: regjionet bazike për aplikimin e politikave regjionale
 - 2.3. NUTS 3: regjionet e vogla për qëllime specifike
3. Përfshirjes së regjioneve të BE-së në një kornizë politike:
 - 3.1. Regjionet të mundshme për mbështetje nga politikat e kohezionit sipas definimit të NUTS 2 nivelit
 - 3.2. Raportimi deri më tani është përgatitur sipas NUTS 2 nivelit.

Tani është valide ndarja e regjioneve sipas NUTS në tri nivele, NUTS 1, NUTS 2 dhe NUTS 3, si dhe dy nivele të LAU dhe kjo LAU-1 dhe LAU-2 (LAU/Local Administrative Units). Deri në Qershor 2003 janë numëruar 5 nivele të NUTS, por nga ky vit fillon dallimi edhe për dy njësi të tjera me të vogla. Por nganjëherë këto njësi numërohen si NUTS 4 dhe 5¹². Krahas këtyre ndarjeve ka ekzistuar edhe ndarja sipas 0 nivelit si një nivel me gjithëpërfshirës dhe ka pasur të bëjë me shtetet me 80 mil e më lartë.

NUTS	NUMRI I BANOREVE (min)	NUMRI I BANORËVE (max)
1	3.000.000	7.000.000
2	800.000	3.000.000
3	150.000	800.000

Shtetet e

Evropës si ato anëtare po ashtu edhe shtetet candidate kanë bërë ndarjen territoriale në tri nivele të NUTS, dhe në dy nivele të LAU duke u bazuar në rregulloren e Komisionit Evropian¹³.

Klasifikimi i NUTS është shfrytëzuar të definojë kufijtë regjional dhe të determinoj pranueshmërin gjeografike për fonde strukturore dhe fonde të investimit. E drejta për të marrë pjesë në Fondin Evropian për Zhvillim regjional/ERDF dhe Fondin Evropian Social/ESF gjatë programimit 2014-2020 është kalkuluar në bazë GDP rajonale për banorë, ndërsa NUTS 2 është ndarë në tri kategori:

- ❖ Rajone më pak të zhvilluara ku GDP për kokë banori është më pak se 75% se sa EU-28 mesatarja;
- ❖ Rajone në tranzicion ku GDP për kokë banori është në mes të 75% dhe 90% e EU-28 mesatares;
- ❖ Rajone më të zhvilluara ku GDP për banorë është më shumë se 90% e EU-28 mesatares së përcaktuar.

Duke marrë për bazë shtetet me karakteristika të ngjashme me Kosovën (territor, popullsi, zhvillim ekonomik), Kosova mund të ketë klasifikim sipas NUTS klasifikimit si në vijim:

Klasifikimi	NUTS 1		NUTS 2		NUTS 3	
Kosova	Tërë territori	1	Tërë territori	1	Rajone ekonomike/zhvillimore	5

Figura 2. Harta e Kosovës sipas NUTS 1 dhe NUTS 2

¹² <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A32015R2381>

¹³ Regulation (EC) No 1059/2003,



Klasifikim të ngjashëm të komplet territorit për NUTS 1 dhe NUTS 2 kanë këto shtete:

- ✓ Anëtare të BE: Estonia, Lituania, Letoni, Luksemburgu
- ✓ Shtete kandidate për BE: Maqedonia, Mali i zi
- ✓ EFTA shtete: Lihtenshtajni

Figura 3. Harta e Kosovës sipas Klasifikimit NUTS 3



Klasifikim të territorit me NUTS 3 kanë këto shtete:

- ✓ Anëtare të BE: Estonia (5 rajone), Lituania (10 rajone), Letoni (6 rajone), Sllovenia (12 rajone), Luksemburgu (1 rajon)
- ✓ Shtete kandidate për BE: Maqedonia (8 rajone), Mali i zi (1 rajon)
- ✓ EFTA shtete: Lihtenshtajni (1 rajon)

Megjithatë, kjo është një analizë krahasimore lidhur me atë se si mund të jetë Kosova në klasifikimin NUTS dhe nuk prejudikon vendim final rreth kësaj çështje. Kjo ndarje sipas klasifikimit NUTS mund të përdoret si sinonim derisa Kosova të fitoj Statusin kandidat për anëtarësim në BE. Duhet të merren parasysh parametra tjerë në procesin e definimit përfundimtar të ndonjë klasifikimi të mundshëm.

Shtetet e rajonit

Shtetet e rajonit kanë praktika të zhvillimit rajonal që dallojnë me ato nga Kosova. Përvojat e këtyre shteteve janë më mirë të shpjeguara si në vijim.

Përvoja e Maqedonisë:

Zhvillimi Rajonal në Maqedoni është i bazuar në Ligjin për Zhvillim të Barabartë Rajonal¹⁴; Strategjinë Për Zhvillim të Barabartë Rajonal si dhe Planin e Veprimit për çdo rajon planor. Sipas këtij ligji në Maqedoni nuk ka Rajone territoriale administrative por quhen Rajone Planore për efekt të planifikimit, implementimit të planeve për zhvillim rajonal. Gjithsej janë 8 Rajone të cilat kanë të themeluara Qendrat për Zhvillim të Rajoneve Planore. Institucionet përgjegjëse të Zhvillimit të barabartë rajonal janë Këshillat për Zhvillim të barabartë rajonal, Ministria e vetëqeverisjes lokale, Byroja për Zhvillim të barabartë rajonal, Këshillat Rajonale, Qendrat për zhvillimin e rajoneve planifikuese, si dhe Njësit e vetëqeverisjes lokale.

Këshilli për zhvillim të barabartë rajonal është i përbërë nga ministritë e linjës dhe përfaqësues të Këshillave Rajonale të rajoneve planifikuese të cilët janë përgjegjës për koordinimin e politikave sektoriale dhe planet e zhvillimit rajonal dhe politikën makroekonomike. Këshilli gjithashtu ofron opinione mbi planet e zhvillimit të rajoneve planifikuese. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale është përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e politikës kombëtare për zhvillim të barabartë rajonal si dhe për koordinimin me ministritë e tjera të linjës të cilat përgatisin dhe zbatojnë projekte në kuadër të politikës së zhvillimit rajonal.

Byroja për zhvillim të barabartë rajonal është organ funksional i Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe koordinon punën e qendrave për zhvillim të rajoneve planifikuese. Këshillat e Zhvillimit Rajonal janë përgjegjëse për politikën e zhvillimit në nivel rajonal. Qendrat për zhvillim në rajonet planifikuese janë përgjegjës për përgatitjen (programimin) e dokumenteve të planifikimit për zhvillimin rajonal. Njësitë e vetë administrimit lokal (komunat) janë përgjegjës për përgatitjen e projekteve për zhvillimin rajonal, dorëzimin e kërkesave për financim, si dhe zbatimin e projekteve.

Përvoja e Sllovenisë:

Sllovenia që nga viti 2000 është e ndarë në 12 rajone statistikore (niveli NUTS-3), të cilat janë të grupuara në dy rajone të kohezionit (niveli NUTS-2) dhe që zëvendësojnë rajonet historike të vendit. Njësia themelore territoriale funksionale për planifikimin e politikave rajonale dhe zbatimin e detyrave të politikave rajonale është një rajon zhvillimi i cili korrespondon me rajonin statistikor të nivelit NUTS 3. Me qëllim të zbatimit të politikës së BE-së për kohezion, rajonet zhvillimore janë grupuar në dy rajone të kohezionit: Sllovenia Lindore që përfshin Murën, Dravën, Karinthian, Savinjën, Savën Qendrore, Savën e Poshtme, Slloveninë Juglindore, dhe Karniolën-Karstike dhe Sllovenia Perëndimore që përfshin Slloveninë Qendrore, Karniolën e Sipërme, Gorician, dhe Bregdin-Karstike. Këshilli zhvillimor i rajonit është organi vendimmarrës i rajonit të kohezionit.

Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Sllovenisë dhe Ligjit për Zhvillimin Rajonal (Akti për promovimin e zhvillimit të balancuar rajonal), Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë është përgjegjëse për zhvillimin rajonal dhe legjislacionin për zhvillimin e barabartë/të balancuar rajonal. Për më tepër, ajo është përgjegjëse për përgatitjen e programit për zhvillimin kombëtar dhe koordinimin e 12 programeve për zhvillimin rajonal, të përgatitura nga këshillat rajonale. Programi i zhvillimit rajonal përfshin pjesë strategjike dhe programe. Megjithatë, menaxhimi i fondeve të kohezionit të BE-së dhe programet e bashkëpunimit territorial janë përgjegjësi e Zyrës së Qeverisë për Zhvillim dhe Politikën e Kohezionit të BE-së. Pra, 2 ministra ndajnë përgjegjësinë për zbatimin e politikës rajonale/së kohezionit.

Përvoja e Letonisë:

Letonia ka pesë rajone të planifikimit të cilat korrespondojnë me nivelin NUTS 3, dhe në nivelin e ardhshëm ka 33 qeveritë lokale rajonale përfshin 26 rrethe dhe 7 qytete republikane. Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zhvillimit Rajonal është përgjegjëse për politikën e zhvillimit rajonal. Në mënyrë që të rrisin bashkëpunimin Ministror, Këshilli për Zhvillim Rajonal është themeluar për të koordinuar zhvillimin rajonal

¹⁴ Ligji për Zhvillim të barabartë rajonal

dhe planifikimin territorial. Ky Këshill gjithashtu vlerëson dokumentet e planifikimit dhe mbështet koordinimin e zhvillimit rajonal.

Gjithashtu në nivel kombëtar Agjencia Shtetërore për Zhvillim Rajonal menaxhon skemat e ndihmës bashkë-financuar nga Fondet Strukturore. Në nivel rajonal, funksionet kryesore të rajoneve planifikuese janë planifikimi zhvillimit rajonal, zbatimi i projekteve dhe monitorimi. Autoritetet rajonale përgatisin dhe miratojnë planet e zhvillimit rajonal dhe vlerësojnë planet lokale dhe kombëtare për ndikimin e tyre në nivel rajonal. Këshillat e Zhvillimit Rajonal funksionojnë brenda çdo rajoni planifikues dhe përfaqësojnë trupin kryesor për rajonin në nivel vendimmarrës. Çdo rajon ka edhe një agjenci të zhvillimit rajonal që mbështet punën e Këshillit të Zhvillimit Rajonal.

Përvoja e Estonisë:

Territori i Estonisë është i ndarë në pesë rajone të NUTS 3. Këto ndarje janë vetëm për qëllime statistikore dhe administrative të BE-së. Në nivelin e NUTS 4 ka 15 qarqe të cilat janë njësitë rajonale të qeverisë shtetërore me në total 241 komuna.

Në kushtet e përgjegjësisë për politikën e zhvillimit rajonal, Ministri për Çështje Rajonale në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme koordinon politikën rajonale në Estoni. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për monitorimin dhe analizën e zhvillimit rajonal, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikës rajonale në bashkëpunim me ministrinë e tjera. Ministrinë e tjera me një përfshirje në politikat rajonale janë Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Mjedisit.

Përvoja e Kroacisë:

Kroacia, si anëtare e BE-së që nga viti 2013, është strukturuar në 2 rajone të NUTS II, Continental Croatia përfshin 13 qarqe dhe qytetin e Zagrebit, dhe Adriatik Kroacia përfshirë 7 qarqe bregdetare. Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe fondet e BE (MRDEUF) është përgjegjëse për politikat ligjore rajonale dhe planin operativ për zhvillimin rajonal. Në nivel rajonal, të gjitha 21 qarqet janë të detyruar për të formuluar programe 3-vjeçare të integruara strategjike që përfshijnë aktorët lokale. Në nivelin e NUTS II në 2 rajone, partneritetet koordinuese janë ngritur për përfaqësues të qarkut që të takohen dhe të diskutojnë propozimet e përbashkëta projekt, me synimin për të krijuar bazën e projekteve për financim në nivel kombëtar. Më shumë se 20 AZhR-të janë të organizuara kryesisht në nivelin e qarkut dhe luajnë një rol të rëndësishëm në programet 3-vjeçare për bashkë-projektme strategjike në nivel të qarkut si dhe procesin e aplikimit për fonde të BE-së.

Nga përvojat e lartpërmendura Kosova nuk mundet një përvojë si të tillë ta aplikojë për shkak të niveleve të qeverisjes që ndryshojnë, por mund të merr elemente nga modeli i Sllovenisë, Kroacisë dhe Letonisë.

Kapitulli III: Synimi dhe Objektivat

Synimi

Krijimi i politikave adekuatë për zhvillimin rajonal në Kosovë si bazë e zhvillimit të balancuar rajonal të qëndrueshëm.

Objektivat

Objektivat specifike janë:

1. Të zvogëlohet pabarazia e mundshme rajonale, posaçërisht duke stimuluar zhvillimin e balancuar dhe revitalizimin e zonave të marginalizuara (që kanë ngecje në zhvillim);
2. Rritja e konkurrencës së rajoneve nëpërmjet forcimit të kapacitetit të tyre për inovacione, shfrytëzimit optimal dhe valorizimi i pasurisë natyrore, kapitalit njerëzor dhe veçorive ekonomike të rajoneve të ndryshme;
3. Ndërlidhja me politika sektoriale zhvillimore të qeverisë dhe aktiviteteve në nivele të rajoneve duke stimuluar bashkëpunimin ndër-rajonal, ndërkombëtarë dhe ndërkufitar që ndikon në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie të popullatës.
4. Të përgatitet korniza institucionale për të përmbushur kërkesat integruese në Strukturat e BE-së si dhe të sigurohet qasje në instrumentet e asistencës financiare (IPA II, Fondet strukturale dhe investimeve të BE-së)

Kapitulli IV: Opsionet

Opsioni 1 – Status quo

Ky opsion mbështet zhvillimin rajonal i bazuar në parimin e “përkrahjes nga jashtë,” përkatësisht nga BE-ja, që koordinohet sipas nevojave të ministrive të linjës për realizimin e aktiviteteve të tyre. Ky opsion ka vështirësi sa i përket koordinimit në mes akterëve të zhvillimit rajonal dhe Ministrive pasi që nuk ka ndonjë mekanizëm të mirëfilltë të llogaridhënies. Në të njëjtën kohë, nuk ekziston baze e mirëfilltë ligjore dhe e politikave (p.sh. Ligj për Zhvillim të barabartë rajonal; Strategji për Zhvillim të barabartë rajonal, etj.).

Sa i përket aspektit ligjor, ky opsion funksionon në kuadër të Ligjit 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndër-Komunal dhe Rregullores Nr. 09/2013 për nxitjen e Bashkëpunimit Ndër-Komunal.

Aspekti strukturor/organizativ i këtij opsioni është i bazuar në grupimin e komunave që ndjekin logjikën e rajoneve të NUTS edhe klasifikimit të NUTS 3 i cili bën ndarjen në 5 rajone (sipas grupimit aktual të komunave në rajonet ekonomike dhe e sqaruar me lartë në kapitullin 2 – NUTS rajonet).

Për menaxhimin e këtij opsioni, MZHR-ja mbetet institucioni i cili koordinon procesin e hartimit të politikave të Zhvillimit Rajonal, në bashkëpunim me institucionet e tjera, përfshirë ministrinë e linjës, dhe komunat. Ky angazhim bazohet në **RREGULLORE (QRK) NR.16/2017 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 02/2011 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE E NDRYSHUAR DHE E PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 07/2011, RREGULLOREN NR.14/2017 DHE RREGULLOREN NR.15/2017** ku kjo rregullore përcakton mandatin e MZHR-së.”

”Opsioni 2 - Zhvillimi i balancuar rajonal

Modeli i propozuar parashikon krijimin e mekanizmit në nivel qendror që i bashkërendon aktivitetet me Ministrinë e linjës dhe siguron kuadrin ligjor për të njëjtin. Planifikohet të adaptohen Politika për Zhvillim rajonal (konform rekomandimit të BE-së): 1. Strategjia për Zhvillim të Balancuar rajonal (si opsion prioritar që synon të adresojë objektiva e parapara në koncept dokument për zvogëlimin e pabarazive rajonale, rritjen e konkurrencës ndërmjet rajoneve dhe ngritjen e kapaciteteve, ndërlidhjen); 2. Ligji për Zhvillim të

balancuar rajonal, si dhe 3. krijimi i mekanizmit për operacionalizimin e intervenimeve për Zhvillim Rajonal ne sfera/sectorë të caktuara.

Sa i përket aspektit ligjor, ky opsion duhet të bazohet në **RREGULLORE (QRK) NR.16/2017 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 02/2011 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE E NDRYSHUAR DHE E PLOTËSUAR ME RREGULLOREN NR. 07/2011, RREGULLOREN NR.14/2017 DHE RREGULLOREN NR.15/2017** ku kjo rregullore përcakton mandatin e MZHR-së, si dhe në kuadrin ligjor i cili do krijohet për zhvillimin rajonal në Kosovë.

Aspekti strukturor/organizativ i këtij opsion është i bazuar në klasifikimin eventual të ndarjes territoriale sipas klasifikimit NUTS si vijon: NUTS 1 dhe 2 i llogaritet si një territor, kurse NUTS 3 rajone funksionale të cilët do quheshin Rajone Zhvillimore.

MZHR-ja merr përgjegjësinë për koordinimin dhe përgatitjen e kornizës për zhvillim rajonal si dhe vlerësimin e ndikimit rajonal të politikave sektoriale në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e linjës. Kjo është e bazuar ne legjislacioni aktual për qeverisje lokale dhe duke marrë parasysh përgjegjësitë dhe aktivitetet e komunave për zhvillim ekonomik.

Në përputhje me kornizën ligjorë në fuqi, MZHR në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe Ministrinë e Financave, merr pjesë në administrimin e ndihmës së huaj financiare, në fushën e zhvillimit rajonal.

Opsioni 3 -

Ky opsion vazhdon me legjislacionin aktual por ndryshon mënyra e zbatimit, ku MZHR me një marrëveshje ndërinstytucionale i bashkërendon përgjegjësitë që rrjedhin nga ky legjislacion si dhe krijimin e mekanizmit në nivel qendror që bashkërendon aktivitetet me Ministrinë e linjës.

Aspekti strukturor/organizativ i këtij opsioni është i bazuar në ndarjen territoriale sipas klasifikimit NUTS si vijon: NUTS 1 dhe 2 i llogaritet si një territor, kurse NUTS 3 rajone funksionale të cilët do quheshin Rajone Zhvillimore.

Rol udhëheqës të vlerësimit të politikave të zhvillimit rajonal do të mund të luaj Zyra e Kryeministrit përgjegjësi më të mëdha. Përveç zyrës se Kryeministrit rol te rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së statistikave rajonale luan edhe Agjencia Statistike e Kosovës. Opsionet për ta bërë këtë ndërlidhen kryesisht me çështje praktike. Andaj, propozojmë që të themelohet një grup punues, në të cilin do të përfshiheshin Zyra Statistike e Kosovës, MZHR-ja si dhe ministrinë përkatëse të linjës për të identifikuar nevojat më urgjente nga perspektiva për zhvillim rajonal si dhe propozimi i rekomandimeve për t'i përmbushur këto nevoja.

Sa i përket metodologjisë së vlerësimit, propozohet që MZHR të bëjë një detyrë pilot, përkatësisht vlerësimin e një numri të caktuar të politikave sektoriale dhe të identifikojë përmes këtyre vlerësimeve nëse ekziston nevoja për asistencë teknike për ngritje të kapaciteteve në këtë fushë.

Kapitulli V: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale.	Planifikohet të hartohen Politika për Zhvillim rajonal, dhe ne faza të mëvonshme sipas vlerësimeve mund të iniciohet edhe Strategjia për Zhvillim të Balancuar rajonal dhe hartimi i Ligjit për Zhvillim të balancuar rajonal si dhe etj.	Nxjerrja e politikave të qarta për zhvillim rajonal si çështje e parapare në strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026.
Segmenti i popullsisë/sektori/rajoni i shënjestruar	Qytetarët e Republikës së Kosovës.	Qytetarët e Republikës së Kosovës.	Qytetarët e Republikës së Kosovës.
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Organet Lokale dhe Organet Qendrore, qytetarët dhe grupet tjera të interesit	Organet Lokale dhe Organet Qendrore, qytetarët dhe grupet tjera të interesit	Organet Lokale dhe Organet Qendrore, qytetarët dhe grupet tjera të interesit
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	MZHR	MZHR	Zyra e kryeministrit dhe ministritë e linjës
